

“Fuqizimi i qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të Kosovës”

Rekrutimet në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil dhe institucionet e pavarura

Pasqyra e fakteve – Mars 2020

Përmbledhje e Projektit

Ky projekt i Ambasadës Britanike ka filluar në tetor 2016 (Faza 1). Faza 2 është nga shtatori 2018 deri në mars 2020, me Memorandumet e Mirëkuptimit të nënshkruara ndërmjet Ambasadës dhe Kuvendit e Qeverisë së Kosovës, dhe Komunave Prishtinë dhe Pejë. Partner Zbatues i Projektit (PZ) është firma nga BDO nga MB, në partneritet me PSI.

Projekti i ndihmon Qeverisë dhe Komunave në rekrutime për pozitat larta të zgjedhura në shërbimin civil. Projekti punon për të siguruar që njerëzit më kompetent të emërohen në këto pozita, dhe synon ta parandalojë nepotizmin; fuqizojë transparencën, meritokracinë, dhe qeverisjen e mirë; dhe ndihmon që ta kthejë besimin në organet publike. Faza 2 gjithashtu përqendrohet në qëndrueshmëri, d.m.th. në zhvillimin e kapacitetit të komisioneve të rekrutimit për të zhvilluar procese pa përfshirje të jashtme pas marsit 2020.

PZ angazhohet nëpërmjet çdo rekrutimi, përfshirë hartimin e shpalljes, listën e ngushtë të aplikacioneve, intervistat, dhe poentimin përfundimtar të kandidatëve në intervistë. PZ trajnon Komisionet për metodologjinë e bazuar në merita dhe e zbaton atë në të gjitha fazat e procesit paralelisht me Komisionin, por në mënyrë të pavarur. Rezultatet e PZ-së nuk përfshihen në rezultatet përfundimtare të Komisioneve.

Komisioni dorëzon emrat e kandidatëve të vlerësuar më së larti nga ta, te Ministri relevant, Kryetari i Kuvendit apo ai i Komunës. PZ, brenda 48 orëve nga përfundimi i intervistave, në mënyrë të pavarur publikon në uebfaqen e tij, rezultatet e veta për kandidatët që i ka vlerësuar që mund të emërohen. PZ përgatitë një raport të pavarur për Ambasadën, e cila ja dërgon pastaj Kryeministrit/Kryetarit të Kuvendit apo të Komunës. Për shkak të procesit të pavarur të poentimit, kandidatët më të vlerësuar nga PZ mund të jenë të ndryshëm nga ata të Komisionit.

Procesi është dizajnuar për të siguruar që secili kandidat të ketë përvojë të njëjtë gjatë intervistës, si dhe mundësi të barabartë për të demonstruar gatishmëri për pozitën në të cilën aplikon. Hollësi të mëtejme gjenden në pakon e Konferencës dhe në faqen e projektit – www.kosovoselection.org.

Janë hasur disa sfida. PZ vazhdon të punojë në fuqizimin e procesit. Ka ofruar një input MPA-së për Rregulloren për Emërimet në Pozita të Larta Drejtuese e cila duhet hartuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrarët Publik.

Rezultatet kryesore

- Janë përfunduar 48 procese rekrutimi – 36 për institucionet qendrore, 7 për institucionet komunale (Prishtinë & Pejë), dhe 5 për Fondacionin e Mileniumit për Kosovën. Shih listën më poshtë.
- Edhe 8 procese tjera kanë arritur deri në fazën e listës së ngushtë por nuk kanë rezultuar me numër të mjaftueshëm të kandidatëve për t'u intervistuar; 9 procese kanë filluar por ka pasur vonesa; dhe 20 procese janë zhvilluar pa përfshirjen e Partnerit Zbatues.
- Një gamë e gjerë e akterëve të lartë tashmë janë trajnuar për metodologjinë e intervistave bazuar në kompetencë dhe ky numër është në rritje.
- Pas këtij trajnimi, disa akterë i kanë përdorur veçoritë kryesore të kësaj qasjeje në procese të tjera rekrutimi që janë jashtë përgjegjësisë së drejtpërdrejt të këtij projekti.
- Faqja www.kosovoselection.org është lansuar në dhjetor 2018. Kjo ka rritur transparencën, dhe mundëson PZ-në që të publikojë vlerësimet e veta të kandidatëve pas secilit proces.
- Format i standardizuar i vlerësimit e ka rritur konsistencën e praktikës te Komisionet e rekrutimit, gjë që ndihmon sigurimin e trajtimit të barabartë të të gjithë kandidatëve.
- Në disa raste ka pasur aplikacione të kalibrit të lartë, por në shumë të tjera cilësia dhe shumëllojshmëria e aplikantëve ka qenë zhgënjyese. Është e dëshirueshme që të gjenden mënyra të reja për të tërhequr kandidatë më cilësor dhe inkurajuar diversitet më të madh të aplikantëve.

Tabela në vijim paraqet rezultatet për 85 procese që është synuar të përkrahen:

Procesi plotësisht kënaqshëm	33 (38.8%)
Procesi pjesërisht kënaqshëm	2 (2.4%)
Procesi ka përfunduar, Vendimi për emërimin në pritje	7 (8.2%)
Procesi i pakënaqshëm	14 (16.5%)
Procesi i kryer pa përfshirjen e Partnerit Zbatues	20 (23.5%)
Procesi i filluar por subjekt i vonesave	9 (10.6%)

PROCESET E PËRFUNDUARA TË REKRUTIMEVE: TETOR 2016 DERI NË MARS 2019

1. Pozitat në institucionet qendrore

Organizata	Pozita	Data
Dogana e Kosovës	Drejtori i Përgjithshëm	Jan-17
Agjencia e Punësimit	Drejtori i Përgjithshëm	Mar-17
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	Anëtarët e Bordit	Prill-17
Posta dhe Telekomit i Kosovës	Anëtarët e Bordit	Maj-17
Ministria e Drejtësisë - Shpallja 1 (vetëm lista e ngushtë)	Sekretari i Përgjithshëm	Maj-17
Shërbimi Korrektues i Kosovës - Shpallja 1	Drejtori i Përgjithshëm	Qer-17
Ministria e Drejtësisë - Shpallja 2	Sekretari i Përgjithshëm	Nën-17
Agjencia për Pronësi Industriale – Shpallja 1 (vetëm lista e ngushtë)	Drejtori	Dhje-17
Agjencia e Kosovës për Akreditim – Shpallja 1 (vetëm lista e ngushtë)	Drejtori	Dhje-17
Zyra Rregullatore e Energjisë në Kosovë	Anëtarët e Bordit Ekzekutiv	Dhje-17
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Sekretari i Përgjithshëm	Dhje-17
Agjencia për Arsim & Aftësim Profesional & Arsim për të Rritur	Drejtori	Jan-18
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Sekretari i Përgjithshëm	Jan-18
Instituti i Mjekësisë Ligjore – Shpalljet 1 & 2 (vetëm lista e ngushtë)	Drejtori	Shk-18
Shërbimi Korrektues i Kosovës - shpallja 2	Drejtori i Përgjithshëm	Mar-18
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (1)	Drejtori	Mar-18
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (1)	Zëvendësdrejtori	Mar-18
Bordi i Telekomit	Drejtorët e Bordit	Mar-18
Agjencia për Eficiencë të Energjisë (vetëm lista e ngushtë)	Kryeshefi Ekzekutiv	Mar-18
Agjencia Qendrore e Prokurimit	Drejtori	Mar-18
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në Kosovë	Drejtori	Korr-18
Zyra Rregullatore e Energjisë në Kosovë (Bordi)	Kryesuesi	Korr-18
Policia e Kosovës	Drejtori i Përgjithshëm	Gusht-18
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (2)	Drejtori	Shtat-18
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (2)	Zëvendësdrejtori	Shtat-18
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	Drejtori Menaxhues	Tet-18
Agjencia e Kosovës për Akreditim	Drejtori	Tet-18
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	Sekretari i Përgjithshëm	Nën-18
Avokati i Përgjithshëm Shtetëror	Avokati i Përgjith. Shtetëror	Nën-18
Komisioni për Ndihmë Shtetërore	Anëtarët e Komisionit	Dhje-18
Operator Sistemi dhe Transmisioni në Kosovë (KOSTT)	Anëtarët e Bordit	Jan-19
Policia e Kosovës	Zëven.drejtor i Përgjithshëm	Jan-19
Administrata Tatimore	Drejtori i Përgjithshëm	Shk-19
NKEC	Anëtarët e Bordit	Mar-19
Agjencia e Punësimit	Drejtori i Përgjithshëm	Prill-19
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës	Anëtarët e Bordit	Prill-19
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (1)	Komisioneri	May19
Organi Shqyrtues i Prokurimit (vetëm lista e ngushtë)	Anëtarët	Maj-19
KPMSHC - komunitetet joshumicë. Shpallja 1. (vetëm lista e ngushtë)	Anëtarët e Bordit	Qer-19
RTK – komuniteti shumicë	Anëtarët e Bordit	Qer-19
RTK – komunitetet joshumicë	Anëtarët e Bordit	Korr-19
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2)	Komisioneri	Korr-19
Komisioni i Pavarur i Mediave	Anëtarët	Qer-19

Të përfunduara tërësisht: 36

Vetëm lista e ngushtë: 7

2. Municipal Positions

Ndërmarrja Publike Banesore Prishtina	Anëtarët e Bordit	Dhje-18
Stacioni i Autobusëve në Prishtinë	Kryeshefi Ekzekutiv	Jan-19
Ndërmarrja Prishtina Parking	Anëtarët e Bordit	Shk-19
Stacioni i Autobusëve në Pejë	Anëtarët e Bordit	Mar-19
Ndërmarrja Prishtina Parking - 2	Anëtarët e Bordit	Qer-19
Termokos	Kryeshefi Ekzekutiv	Qer-19
Ndërmarrja Prishtina Parking (vetëm lista e ngushtë)	Kryeshefi Ekzekutiv	Shk-20
Ndërmarrja Publike Banesore Prishtina	Kryeshefi Ekzekutiv	Shk-20

Të përfunduara tërësisht: 7

Vetëm lista e ngushtë: 1

3. Fondacioni i Mileniumit për Kosovën (Dhjetor 2017 - Mars 20): Projekti ka përkrahur edhe rekrutimin e **5 pozitave** për MFK: Kryeshef Ekzekutiv, Drejtor për Admin & Financa, Menaxher i Prokurimit, Drejtor për Qeverisje, Drejtor për Energji.